



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**

**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**Nr. 283**  
**dt. 03.09.2015**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

**N J O F T I M**

**PËR TË GJITHË KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR PËR  
MËSIMDHËNËS NË  
KONKURSET E DATËS 04.08.2015 DHE 18.08.2015**

Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) e Komunës së Prishtinës, sot më 03 shtator 2015, ka bërë publikimin e databazës me të dhënat e kandidatëve që kanë aplikuar për punësim në institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar dhe në bazë të kriterëve ka bërë përzgjedhjen e 5-6 kandidatëve për intervistim, për secilën pozitë, të cilët kanë aplikuar sipas konkurseve të datës 04.08.2015, 18.08.2015.

Përzgjedhja është bërë në monitorimin e shoqërisë civile dhe sipas procedurës së përzgjedhjes, kriterëve të paraseleksionimit dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dokumente të cilat tashmë kanë qenë publike për të gjithë kandidatët, edhe në web faqe të Komunës.

Kushdo që konsideron së është bërë ndonjë gabim ose lëshim teknik në databazën e konkurseve, të dt. 04.08.2015 për mësimdhënës në gjuhën turke dhe me 18.08.2015 për mësimdhënës në lëndën e kimisë, mund të ushtrojë ankesë në afat prej pesë (7) ditësh: prej **03.09.2015 deri me 09.09.2015** në DKA, e cila do të kthejë përgjigje brenda afatit ligjor.

Në rast se, pas ankesave tuaja, verifikohet se ka pasur lëshime teknike, të njëjtit do të ftohen në Intervistë. Kjo në asnjë mënyrë nuk prejudikon

rezultatit përfundimtar gjatë intervistimit. Prandaj, edhe data-baza me përmirësime do të publikohet pas shqyrtimit të ankesave.

Për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit).

Gjatë paraseleksionimit kanë hyrë në konkurrencë vetëm kandidat qe i plotësojnë kriteret e veçanta të konkursit publik sipas UA 06/02015, **përkatësit vetëm kandidatet që i kanë përfunduar studimet-themelore dhe master në drejtimin: *kimi arsimore*.**

- Kandidatët e përzgjedhur për intervistim janë kandidatët e parë, rreshtat e të cilëve janë hijezuar fund e krye me ngjyrë të kuqe.
- Kandidatët që janë të hijezuar fund e krye me ngjyrë të bardhë janë kandidatë që posedojnë **vetëm studimet-themelore përkatës dhe master jo përkatës**, sipas udhëzimit UA 06/02015, te cilët nuk kanë hy në konkurrencë sepse ka kandidat të mjaftueshëm që i plotësojnë kriteret sipas udhëzimit.
- Kandidatët që janë të hijezuar fund e krye me ngjyrë të verdhë janë kandidatë që edhe në studimet-themelore janë me kualifikime jo përkatëse.

**Vërejtje:** Të gjitha ankesat e paqarta dhe ato jashtë afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen

Me respekt,  
Drejtorja e Arsimit